

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-137/13

**Prishtinë,
10 dhjetor 2013**

Në çështjen juridike të

N.K

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

M.K

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/172/2010 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA 472) të datës 24 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 10 dhjetor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e N.K kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/172/2012, i datës 24 tetor 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA00472.
2. Konfirmohet vendimi i KPCC/D/A/172/2012, i datës 24 tetor 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA00472.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 13 nëntor 2006, N.K ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar ri-posedimin e një pjese të parcelës nr. 583, rruga Marshall Tito, Fleta Poseduese 7821, në sipërfaqe prej 0.03.05 ha, Zona Kadastrale e Pejës, Komuna e Pejës, në të cilën ai ka pretenduar se fqinji i tij e kishte ndërtuar një objekt me sipërfaqe prej 11 metrash katrorë. Fqinji, M.K, ishte cekur në kërkesë si uzurpues. Krasniqi nuk është përgjigjur në kërkesë.
2. Më 24 tetor 2012, me vendimin e tij KPCC/D/A/172/2012, të datës 24 tetor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore e ka hedhur poshtë kërkesë. Në paragrafin 18 në vendimin grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar të datës 24 prill 2013 vlen posaçërisht për këtë kërkesë, thuhet se sipas dokumenteve të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës e të cilat janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive apo janë konfirmuar nga paraqitësi i kërkesës, paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur që të dëshmojë se kërkesa e tij ka të bëjë me rrethanat që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur i viteve 1998-1999. Në këtë mënyrë, kërkesa është konsideruar se ishte jashtë mandatit të Komisionit dhe ishte hedhur poshtë.
3. Vendim i KKKP-së i ishte dorëzuar K. më 28 maj 2013. Ai e kishte kundërshtuar vendimin me 19 qershor 2013. Në ankesë, M.K ceket si palë përgjegjëse në ankesë. Megjithatë, ankesa nuk i ishte dorëzuar M.K.
4. Gjykata Supreme e ka pranuar lëndën më 22 nëntor 2013.

5. Pasi që M.K në ankesë ceket si palë përgjegjëse në ankesë, Gjykata Supreme e ka regjistruar atë si palë përgjegjëse në ankesë. Gjykata nuk e ka parë të nevojshme që të marrë deklaratë nga M.K lidhur me këtë çështje.

Pretendimet e palëve

6. N.K pretendon se vendimi i KKPK-së është faktikisht i pabazuar, logjikisht i pakuptimtë dhe ligjërishit i pabazuar dhe i paligjshëm, duke iu referuar posaçërisht deklaratimit në paragrafin 2 të vendimit të vërtetuar, i cili thekson se:

“Komisioni ka vërejtur se kur pronat në fjalë janë të uzurpuara, vendimi i lartpërmendur nuk i jep ndonjë të drejtë palëve përgjegjëse në kërkesë apo uzurpuesve aktual.”

7. Pretendimi kryesor i N.K është se fqinji i tij, M.K, e ka ndërtuar një objekt që arrin deri të prona e N.K e që përfshin 11 metra katrorë dhe, në këtë mënyrë, e ka uzurpuar një pjesë të pronës së N.K. Kjo krijon vështirësi për N.K sepse hyrja në pronën e tij tani është vetëm 80 cm. Uzurpimi përfshinë periudhën kohore prej 23 mars 1989 dhe 24 mars 1999, prandaj edhe mbulohet nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23. Vendimi i KKPK-së është në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (tani e tutje: Ligji Nr. 03-079), neni 8.1 dhe 8.2 (e drejta në privatësi), neni 6 (e drejta për gjykim të drejtë) i KEDNJ-së, Protokollit 1 dhe 2 për mbrojtjen dhe respektimin e pronës, neni 46 i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 1 dhe 4 i Ligjit për Pronën që parashohin mbrojtjen kundër diskriminimit.
8. Në ankesë, N.K jep një sqarim të hollësishëm të kontestit ndërmjet tij dhe M.K. Ai po ashtu deklaron se ka paraqitur padi rreth kësaj çështje në Gjykatën Themelore të Pjesë para luftës në vitin 1999. Kjo lëndë është ende e pazgjidhur pasi që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës e ka prishur më 8 nëntor 2008 aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Pejës të datës 7 gusht 2008.
9. M.K nuk është njoftuar rreth lëndës as nga KKPK-ja e as nga Gjykata Supreme dhe nuk ka dhënë ndonjë deklaratë lidhur me rastin.

Arsyetim Ligjor

10. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditës të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit Nr. 03-079 dhe është e pranueshme.

11. Megjithatë, Gjykata Supreme pajtohet me qëndrimin juridik të KKPK-ës se kërkesa nuk është në juridiksion të KKPK-së dhe në këtë mënyrë nuk është në juridiksion të Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme po ashtu pajtohet plotësisht me arsyen e dhënë nga KKPK-ja në vendimin e saj.
12. KKPK-ja ka marrë vendimin e vërtetuar të datës 24 prill 2013. Në këtë vendim janë referuar “paragrafët relevant” në Vendimin Grupor të datës 14 tetor 2012. Një referim i veçantë iu është bërë paragrafëve 12, 18 dhe 91. Arsyetimi i KKPK-së nuk është lehtë i qasshëm. Prandaj, Gjykata Supreme do të jap një përmbledhje të shkurtër të arsyeve se përse KKPK-ja nuk ka juridiksion në këtë rast.
13. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për të zgjidhur kërkesat që ndërlidhen me konfliktin e që kanë të bëjnë me pronësinë apo të drejtat pronësore ndaj pronës së paluajtshme private duke përfshirë edhe pronën bujqësore dhe atë komerciale. KKPK-ja është kompetent vetëm nëse kërkesat janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
14. Në këtë rast konkret. AKP-ja ka vërejtur se N.K pretendon se 11 metra katrorë të pronës së tij ishin uzurpuar nga fqinji i tij që 33 vite. Vetë N.K ka deklaruar në ankesë se uzurpimi i pronës së tij përfshinë periudhën nga 23 mars 1989 deri më 24 mars 1999. Është e qartë se kërkesa ka të bëjë me një kontest që kishte filluar para vitit 1998 dhe se nuk ka lidhje dhe nuk rezulton nga konflikti i armatosur i viteve 1998/1999.
15. Gjykata Supreme gjithashtu vëren se kontesti ishte në vazhdim e sipër pranë Gjykatës Themelore të Pejës kur kërkesa ishte bërë në AKP, prandaj ajo duhet të hedhet poshtë në përputhje me nenin 262 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.
16. Pasi që KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit të AKP-së nuk kanë juridiksion në këtë rast, as KKPK-ja e as Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme nuk i ka shqyrtuar meritat e lëndës, për të cilat do të duhej të vendosej në mënyrë të pavarur nga gjykatat e rregullta në Kosovë.
17. Gjykata Supreme ka vërejtur se N.K e kundërshton deklarinimin e bërë nga KKPK-ja, e i cili është cituar në paragrafin 6 më lartë. Gjykata Supreme konsideron se kjo deklaratë ka të bëjë vetëm kompetencën e KKPK-ës ashtu siç është theksuar në Ligjin Nr. 03-L-079

Këshillë ligjore

18. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it